

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021
ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Qershor 2021

Ora 10.00

Lënda:Ekonomi

EA

VARIANTI A

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda hapësirës së dhënë.

Kërkesa	2	7a	7b	7c	8	11	13a	13b	13c	14	17	18a
Pikët												
Kërkesa	18b	19a	19b	23a	23b	23c	23d	29	31	32	34	
Pikët												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Në një ekonomi prodhohen 30 njësi veshje dhe 60 njësi ushqime. Supozojmë se ky është një kombinim i pozicionuar nën Kufirin e Mundësive të Prodhimit. Kjo nënkupton: **1 pikë**

- A) kosto oportune konstante
- B) kosto oportune rritëse
- C) papunësi
- D) përdorim eficient të burimeve

2. Krahasoni tri tipare thelbësore që ndryshojnë midis ekonomisë së komanduar në Shqipëri para viteve 90' dhe ekonomisë së tregut në të cilën jetojmë sot. **3 pikë**

3. Oferta e tregut për një mall është e ndikuar nga: **1 pikë**

- A) çmimet e faktorëve të prodhimit.
- B) çmimet e mallrave zëvendësues dhe plotësues në konsum.
- C) numri i konsumatorëve.
- D) të ardhurat e konsumatorëve.

4. Sipas Ligjit të Kërkesës, nëse çmimi i automobilave në treg do të rritej: **1 pikë**

- A) kërkesa për automobila do të ulej.
- B) oferta për automobila do të rritej.
- C) sasia e kërkuar për automobila do të ulej.
- D) sasia e ofruar për automobila do të rritej.

5. Tregu i zi dhe radhët e konsumatorëve janë dukuri që krijohen në rastin e vendosjes së: **1 pikë**

- A) çmimeve dysheme
- B) çmimit ekuilibër
- C) çmimeve tavan
- D) tepricës në ofertë

6. Në kushtet e një lakore oferte me pjerrësi pozitive për mobilje, në qoftë se taksat mbi lëndën drusore që përdoret si lëndë e parë në prodhimin e mobiljeve do të uleshin, atëherë do të kemi: **1 pikë**

- A) zhvendosje në të djathtë të lakores së ofertës për mobilje dhe rritje të çmimit ekuilibër.
- B) zhvendosje në të majtë të lakores së ofertës për mobilje dhe rritje të çmimit ekuilibër.
- C) zhvendosje në të djathtë të lakores së ofertës për mobilje dhe rënie të çmimit ekuilibër.
- D) zhvendosje në të majtë të lakores së ofertës për mobilje dhe çmim ekuilibër të pandryshuar.

7. Tabela e mëposhtme tregon kërkesën dhe ofertën në treg për qershi (në mijë ton).

Çmimi (lek)	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
70	10	70
60	30	60
50	50	50
40	70	40
30	90	30

a) Sa do të jetë sasia dhe çmimi ekuilibër?

1 pikë

Sasia ekuilibër: _____ Çmimi ekuilibër: _____

b) Kushtet e pafavorshme të motit (reshje të dendura shiu dhe erëra të forta) do të ndryshojnë sasinë e ofruar me 30 njësi për çdo nivel të çmimit. Sa do të jetë sasia dhe çmimi i ri ekuilibër?

1 pikë

Sasia ekuilibër: _____ Çmimi ekuilibër: _____

c) Paraqiteni grafikisht këtë situatë, duke përcaktuar ekuilibrin fillestar dhe ekuilibrin e ri, pas ndryshimit në pikën (b).

1 pikë

8. Krahasoni elasticitetin e kërkesës për çdo grup të mirash.

a) Kërkesa për bukë ndaj kërkesës për bizhuteri:

1 pikë

b) Kërkesa për stilolapsa ndaj kërkesës për makina:

1 pikë

9. Një familje përbëhet nga 4 anëtarë, prindërit dhe dy fëmijë. Të ardhurat nga puna e të dy prindërve në total janë në masën 180.000 leke/muaj. Familja zotëron një apartament që e jep me qera 45.000 lekë në muaj dhe një lokal që e jep me qera 50.000 lekë në muaj. Shpenzimet gjithsej të kësaj familjeje vlerësohen në masën 170.000 lekë/muaj. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë?

1 pikë

- A) të ardhurat mujore nga renta 180.000 lek dhe kursimi 75.000 lekë
- B) të ardhurat mujore nga renta 275.000 lek dhe kursimi 10.000 lekë
- C) të ardhurat mujore nga renta 95.000 lek dhe kursimi 105.000 lekë
- D) të ardhurat mujore nga renta 0 lek dhe kursimi 180.000 lekë

10. Cilat nga mënyrat e mëposhtme financiare të ruajtjes (investimit) së kursimeve karakterizohet nga siguri më e lartë? **1 pikë**

- A) Blerje e aksioneve në bursë.
- B) Depozitimi i parave në një llogari kursimi 6 mujore në bankë.
- C) Investimi në Kompaninë X, duke blerë obligacione të saj.
- D) Mbajtja e parave në shtëpi.

11. Elsa ka vendosur të krijojë një biznes, të cilin dëshiron ta regjistrojë në pronësi të saj si dhe ta drejtojë ajo vetë.

Renditni dy përparësi dhe dy të meta që Elsa duhet t'i ketë në konsideratë për krijimin e firmës së saj individuale. **4 pikë**

Përparësi: _____

Përparësi: _____

Të meta: _____

Të meta: _____

12. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën një burim financiar të jashtëm të firmës?

1 pikë

- A) Riinvestimi i një pjese të fitimit të siguruar nga firma.
- B) Përdorimi i rezerva të brendshme të cilat nuk janë shfrytëzuar.
- C) Përdorimi i fondit të amortizimit që nuk është përdorur për zëvendësimin e makinerive.
- D) Marrja e borxheve nga institucione huadhënëse si, bankat ose kompanitë e sigurimit.

13. Një firmë vepron në kushtet e konkurrencës së plotë në tregun e produktit X. **3 pikë**

Nivelet e kostos së përgjithshme paraqiten në tabelë:

Q	0	1	2	3	4	5
Kosto e Përgjithshme (lek)	5	10	14	18	21	23

a) Ç'kuptim ka kostoja e përgjithshme e barabartë me 5 lek në nivelin zero të prodhimit?

b) Sa është kosto variabël, kur firma ka prodhuar 4 njësi produkt?

c) Sa është kosto marginale, kur firma kalon nga niveli i 2 në të 3 të prodhimit?

14. Identifikoni dy pengesa në hyrje për tregun monopol.

2 pikë

15. Në shpenzimet kapitale të qeverisë **NUK** përfshihen: **1 pikë**

- A) subvencione për fermerët si pasojë e ndikimit të motit të keq në produktet bujqësore.
- B) shpenzime për ndërtimin e spitaleve.
- C) shpenzime për ndërtimin e aeroporteve të reja.
- D) shpenzime për ndërtimin e ujësjellësit të Bovillës.

16. Në qoftë se shteti synon të pakësojë pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave personale, ai do të tentojë të zbatojë një sistem taksash: **1 pikë**

- A) regresiv
- B) progresiv
- C) të sheshtë (proporcionale)
- D) të tërthortë

17. Listoni 3 mënyra të financimit të një buxheti me deficit. **3 pikë**

18. “Paniku Bankar” ndodh në situata kur depozituesit mendojnë se depozitat mund të humbasin dhe kërkojnë tërheqjen e menjëhershme të tyre.

Identifikoni:

a) rrezikun kryesor që u kanoset bankave në të tilla situata. **1 pikë**

b) dy masa që bankat ndërrmarin për të ulur rrezikun e panikut bankar. **2 pikë**

19. Identifikoni veprimet e mëposhtme, sipas komponentëve përbërës së PBB me metodën e shpenzimeve. **2 pikë**

a) Në Korçë punësohen më tepër edukatorë në kopshte: _____

b) Fabrika MODA prodhon veshje në Tiranë dhe i shet në Itali: _____

20. Në Amerikë shumë vende pune në sektorin e prodhimit të veshjeve janë zhvendosur në fabrika në Kinë. Punonjësit e kualifikuar të sektorit të veshjeve në Amerikë kanë humbur punën e tyre. Ky shembull është një rast i papunësisë:

1 pikë

- A) sezonale
- B) friksionale
- C) ciklike
- D) strukturore

21. Nëse Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit në Maqedoni në vitin 2016 është: $CPI = -0.4$, atëherë mund të themi se kemi të bëjmë me: **1 pikë**

- A) deflacion
- B) hiperinflacion
- C) inflacion galopant
- D) inflacion i moderuar

22. Gjatë fazës së gjallërimit apo rritjes ekonomike të një cikli biznesi ndodh: **1 pikë**

- A) rënie e prodhimit.
- B) rritje e shpenzimeve për konsum.
- C) tkurrje e bizneseve dhe rënie e investimeve.
- D) ulje e besimit të njerëzve të cilët nisin të shpenzojnë më pak.

23. Sipas Anketës së Forcës Punëtore të vitit të shkuar paraqiten të dhënat e mëposhtme: Të punësuar gjithsej janë 900,000 individë ndërsa Të Papunë gjithsej janë 500,000 individë. Papunësia friksionale vlerësohet në 120,000 individë ndërsa Papunësia strukturore në 80,000 individë.

Llogarisni:

a) Forcën punëtore (në total individësh). **1 pikë**

b) Normën e papunësisë (në %). **1 pikë**

c) Papunësinë Natyrore (në total individësh). **1 pikë**

d) Normën e papunësisë në punësim të plotë (në %). **1 pikë**

24. Si pasojë e rritjes së çmimit të naftës, bizneset vendosin të rrisin çmimet e produkteve që ata prodhojnë. Në këtë rast kemi të bëjmë me inflacion të shkaktuar nga: **1 pikë**

- A) Kërkesa
- B) Kostoja
- C) Spirala pagë – çmim
- D) Spirala çmim – pagë

25. Për vitin e ardhshëm qeveria synon një rritje të PBB me 4%. Për të stimuluar këtë rritje, qeveria mund të: **1 pikë**

- A) ulë taksat, duke mbajtur të pandryshueshëm nivelin e shpenzimeve.
- B) rrisë taksat, duke mbajtur të pandryshueshëm nivelin e shpenzimeve.
- C) ulë shpenzimet qeveritare, duke mbajtur të njëjtin presion fiskal.
- D) rrisë taksat dhe të pakësojë shpenzimet qeveritare.

26. Një bankë X ka një depozitë prej 250 milionë lekë. Banka Qëndrore rrit normën e rezervës së detyrueshme nga 5% në 10%. Si pasojë e këtij ndryshimi, Banka X: **1 pikë**

- A) do të japë më pak kredi, duke ndikuar në rritjen e ofertës monetare.
- B) do të japë më pak kredi, duke ndikuar në rënien e ofertës monetare.
- C) do të japë më shumë kredi, duke ndikuar në rritjen e ofertës monetare.
- D) do të japë më shumë kredi, duke ndikuar në uljen e ofertës monetare.

27. Një tarifë e vendosur mbi importin e makinave: **1 pikë**

- A) kufizon sasinë e importuar të makinave në vendin importues.
- B) mbron prodhuesit e huaj.
- C) rrit sasinë e importuar të makinave në vendin importues.
- D) ul çmimin e makinave të importuara.

28. Në datën 25.02.2021 kursi i këmbimit të euros me lekë ishte 1 euro= 125 lek. Në datën 26.02.2021 kursi i këmbimit të euros me lekë ishte 1 euro= 120 lek. Në këtë rast mund të themi se: **1 pikë**

- A) euros i është rritur vlera në krahasim me lekun.
- B) lekut i është rritur vlera në krahasim me euron.
- C) lekut i ka rënë vlera në krahasim me euron.
- D) vlera e euros dhe lekut nuk ka ndryshuar.

29. Në bizneset globale çështjet etike bëhen edhe më të komplikuar.

Identifikoni tri arsye që e bëjnë të vërtetë këtë pohim.

3 pikë

30. Era drejton Departamentin e Projekteve në Institutin e Studimeve Evropiane. Ajo në fillim të çdo muaji ndërton planin e punës së Departamentit të saj, duke përcaktuar objektivat dhe duke vendosur përparësitë. Cila është aftësia për sukses që po përdor Era në këtë rast? **1 pikë**

- A) Përkrah dhe ndikoj
- B) Zgjidh dhe negocioj konfliktin
- C) Planifikoj
- D) Mësoj përmes kërkimit

31. Genti dhe Deni po punojnë së bashku për një strategji të re shitjeje për produktin e ri të kompanisë, me qëllim që të arrijnë një zgjidhje më të mirë nga ç' mund të arrijë secili më vete. Gjithashtu, ata po përpiqen të aftësohen të prezantojnë në mënyrë efektive para Bordit Drejtues vlerat dhe kontributin e punës së tyre, me qëllim promovimin personal në të ardhmen. Bazuar në këtë shembull, renditni dy elementet kryesore që Genti dhe Deni po përdorin për të patur sukses në punën e tyre (Aftësia për sukses): **2 pikë**

32. Në kuadër të Financave Personale, jepni dy shembuj të shpenzimeve të ndryshueshme dhe një shembull të shpenzimeve të pandryshueshme që një individ mund të ketë: **3 pikë**

Shpenzime të ndryshueshme: _____

Shpenzime të ndryshueshme: _____

Shpenzime të pandryshueshme: _____

33. Cili është hapi i fundit për një sipërmarrje të sukseshme?

1 pikë

- A) Plani i Biznesit
- B) Tregu i duhur
- C) Sfidat e Konkurrimit
- D) Sipërmarrës i informuar

34. Argumentoni tri mënyra mes të cilave një biznes mund të ndryshojë prodhimin e tij për të fituar një përparësi konkurruese: **3 pikë**
